



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Rruga "Jordan Misja", Pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda

Tel. +355 4 2232 852

Nr. 439 Prot.
(lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 07 . 04 .2010

Lënda: Dërgohet raporti statistikor mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës për muajin Mars 2010

Drejtuar: **Z. BUJAR NISHANI**
MINISTËR I DREJTËSISË

TIRANË

I nderuar Z. Ministër!

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative"", po Ju paraqesim raportin statistikor mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës për muajin Mars 2010.

Duke Ju uruar punë të mbarë!

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARBEN SEFGJINI

Konceptoi: Saimir Shyti
Datë 07.04.2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
DREJTORIA E PERGJITHESHME

R A P O R T
PËR MUAJIN MARS 2010

I nderuar Zoti Ministër,

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative", po Ju paraqesim raportin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës për muajin Mars 2010.

I. Statistika

Për periudhën 01-31 Mars 2010, Shërbimi i Provës ka kryer një volum pune të madh, duke marre parasysh faktin që numri i specialistëve të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës është i njëjti, ndërsa numri i të dënuarve me dënime alternative që këta specialistë mbikqyrin, si dhe kërkesat nga Gjykata dhe prokuroritë për raporte vlerësimi janë në rritje të vazhdueshme. Disa nga statistikat dhe paraqitjet që pasqyrojnë punën që ka kryer e po kryen institucioni do të jepen me anë të të dhënave si më poshtë:

Për periudhën Mars 2010, statistikat rezultojnë si më poshtë:

1. Numri total i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës.

Numri total i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës në të gjithë vendin, për periudhën 01.06.2009 - 31.03.2010 është 1167 të dënuar, për muajin mars 2010 (nga 01.03.2010-31.03.2010) është shtuar me 115 të dënuar.

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Tiranë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **589** të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Durrës mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **184** të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Fier mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **237** të dënuar me dënime alternative.

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Shkodër mbikqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **157** të dënuar me dënime alternative.

2. Numri mesatar i të dënuarve me dënime alternative që mbikqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe zyre vendore.

Aktualisht është **43** numri mesatar i të dënuarve që mbikqyren nga një punonjës në nivel vendi. E shprehur kjo për çdo zyrë vendore , është si më poshtë:

- Zyra Vendore Tiranë ka nën mbikëqyrje **59** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Durrës ka nën mbikëqyrje **30** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Fier ka nën mbikëqyrje **47** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Shkodër ka nën mbikëqyrje **26** të dënuar për çdo punonjës.

Duke ju referuar statistikave, për muajin Mars 2010 kemi një shtesë prej **115** të dënuarish nën mbikqyrje gjë e cila rrit dhe ngarkesën e punës për specialistët.

3. Numri i të dënuarve për secilin lloj dënimi alternativ.

Statistikat për periudhën **01.06.2009 - 31.03.2010**, për secilin lloj dënimi alternativ, janë si më poshtë:

- **950** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59 i KP "pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë", shifër kjo e barabartë me **81.4%** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- **17** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59/a i KP "qëndrim në shtëpi", shifër kjo e barabartë me **1.46%** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.

- 82 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 63 i KP "Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik", shifër kjo e barabartë me 7.03% të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- 118 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 64 i KP "Lirim me kusht", shifër kjo e barabartë me 10.11 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- asnjë person nuk është dënuar nga gjykata duke aplikuar nenin 58 të KP "gjysëmliria".

Këto të dhëna pasqyrohen më poshtë, në Tabelën 2.

Tabela 2: Numri i të dënuarëve sipas llojeve të dënimeve alternative të dhëna nga Gjykata për periudhën 01.06.2009 - 31.03.2010.

Nr	LLOJI I DENIMEVE ALTERNATIVE	Nr: TOTAL	TOTALI NE %
1	Pezullimi neni 59 i KP	950	81.4%
2	Qendrimi ne shtepi neni 59/a i KP	17	1.46%
3	Lirimi me kusht neni 64 i KP	118	10.11%
4	Pune në interes publik neni 63 i KP	82	7.03%
5	Gjysem liria neni 58 i KP	0	0.00%
TOTALI		1167	100%

Deri në muajin Shkurt 2010 numri i të dënuarve me "punë në interes publik" ishte 78, ndërsa për periudhën 01.06.2009 - 31.03.2010, ky numër ka shkuar në 82.

4. Raportet e Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.

Konkretisht për muajin Mars 2010:

